



REPUBLIKA E SHQIPËRISË -AUTORITETI I KONKURRENCËS-

Tiranë, 06 Dhjetor 2007

Njoftim për Mediat

Autoriteti i Konkurrencës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës së Maqedonisë

Në mjediset e Autoritetit të Konkurrencës, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Kryetares së Autoritetit të Konkurrencës, Znj. Lindita Milo (Lati) dhe Presidentit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës së Republikës së Maqedonisë, Z. Cedomir Kraljevski.

Sipas marrëveshjes, palët do të bashkëpunojnë për përmirësimin e akteve ligjore në fushën e mbrojtjes së konkurrencës duke shkëmbyer praktikat më të mira si dhe përvojën europiane.

Të dy këto institucione, gjithashtu do të shkëmbejnë informacione dhe ekspertizë për hetimin e çështjeve të ndryshme si dhe do të ndërtojnë së bashku një bazë të dhënash e literature në fushën e konkurrencës.

Kjo marrëveshje do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e punës të të dy institucioneve, por edhe në përgjithësi në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve mike.

Marrëveshja e bashkëpunimit me Maqedoninë është e dyta marrëveshje bilaterale e nënshkruar nga Autoriteti i Konkurrencës me institucionet homologe. Rreth një vit më parë është nënshkruar në Athinë, marrëveshja e bashkëpunimit me autoritetet greke për mbrojtjen e konkurrencës.

Gjithashtu Autoriteti i Konkurrencës është në fazën e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme në Shqipëri për shkëmbimin e informacionit në lidhje me hetimet e ndryshme të Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës

Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Kati IV

Tel: 04 / 23 45 04

Fax: 04 / 23 44 97

E-Mail: competition@caa.gov.al

Website: www.caa.gov.al